



Republika e Maqedonisë së Veriut  
AGJENCIA PËR MBIKËQYRJE TË FINANCIMIT KAPITAL TË SIGURIMIT PENSIONAL (MAPAS)

# AGJENCIA PËR MBIKËQYRJE TË FINANCIMIT KAPITAL TË SIGURIMIT PENSIONAL (MAPAS)

## Plani strategjik 2021-2025

*“Për ditë më të sigurta pensionale”*

# Përmbajtja

Përmbajtja .....	2
Shkurtesat.....	3
Parathënia e Kryetarit të Këshillit të Ekspertëve .....	4
Hyrje .....	5
Misioni .....	6
Vizioni.....	6
Vlerat.....	6
Sistemi pensional në Maqedoninë e Veriut.....	7
Agjencia për Mbikëqyrje të Sigurimit Pensional me Financim Kapital (MAPAS).....	9
Pjesëmarrës kryesorë.....	13
Qëllimi strategjik 1: .....	14
Qëllimi 1.1 .....	15
Qëllimi 1.2 .....	17
Qëllimi 1.3 .....	18
Qëllimi 1.4 .....	20
Qëllimi strategjik 2: .....	21
Qëllimi 2.1 .....	22
Qëllimi 2.2 .....	25
Qëllimi 2.3 .....	27
Qëllimi 2.4 .....	30
Qëllimi 2.5 .....	32
Qëllimi 2.6 .....	34
Qëllimi 2.7 .....	35
Qëllimi strategjik 3: .....	37
Qëllimi 3.1 .....	38
Qëllimi 3.2 .....	39
Qëllimi 3.3 .....	41
Qëllimi 3.4 .....	43
Qëllimi 3.5 .....	45

## Shkurtesat

**AMS-** Agjencia për Mbikëqyrje të Sigurimit

**PBV-**prodhimi bruto vendor

**FVP-**fondi vullnetar pensional

**BE-** Bashkimi Evropian

**FDP-**Fondi i detyrueshëm pensional

**IOPS-**Organizata Ndërkombëtare e Sigurimit Pensional me Financim Kapital  
(International Organisation of Pension Supervisors)

**KLV** – Komisioni për Letra me Vlerë

**MAPAS** – Agjencia për Mbikëqyrje të Sigurimit Pensional me Financim Kapital

**FNM-** Fondi Ndërkombëtar Monetar

**MPPS** – Ministria e Punës dhe Politikës Sociale

**MF-** Ministria e Financave

**BPRMV-**Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut

**OECD-INFE-** Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik  
(Organisation for Economic Co-operation dhe Adevelopment)

**Shtylla e parë** – sigurimi i detyrueshëm pensional dhe invalidor në bazë të solidaritetit të gjeneratës

**BB** – Banka Botërore

**Shtylla e tretë** – sigurimi vullnetar pensional me financim kapital

**DAP** – Drejtoria e të Ardhurave Publike

**Fondi i SPIMV** – Fondi i Sigurimit Pensional dhe Invaliddor i Maqedonisë së Veriut

**FSAP** – Programi për vlerësim të sektorit financiar (Financial Sector Assessment Program)

# FJALIMI I KRYETARIT TË KËSHILLIT TË EKSPERTEVE

Agjencia për mbikëqyrjen e financimit kapital të sigurimit pensional – MAPAS është institucion rregullator dhe mbikëqyrës që në vazhdimësi kujdeset për interesat e anëtarëve dhe anëtarëve të pensionuar të fondeve pensionale dhe e nxit zhvillimin e financimit kapital të sigurimit pensional. Parakushti kryesor për punë të suksesshme është identifikimi i gjendjeve finale dhe pikërisht për këtë MAPAS zbaton një planifikim strategjik si pjesë e menaxhimit bashkëkohor dhe si mjetë për përshtatjen e shpejtë dhe efikase të kushteve të ndryshueshme të veprimit.

Përmes analizës së gjendjes ekzistuese në të cilën punojmë dhe veprojmë, e kemi përkufizuar misionin, vizionin dhe vlerat tona. Gjithashtu i kemi identifikuar qëllimet tona kryesor që duam dhe realisht mundemi që ti arrijmë në periudhë afatmesme, në pajtim me kapacitetet dhe resurset tona, përmes përkufizimit të aktiviteteve. Në kornizën e përcaktuar kohore i kemi përkufizuar edhe masat që do të jenë indikator i qartë për suksesin e aktiviteteve. Gjendja e projektuar për të ardhmen që e synojmë do të jetë motivi ynë kryesor drejt qëllimit.

MAPAS beson dhe pret se duke realizuar aktivitetet e veta të përditushme, do ta realizojë edhe Planin Strategjik 2021-2025. Realizimi i Planit Strategjik 2020-2025 do të ketë ndikim të madh të forcimit të komponentit të financuar kapital të sistemit pensional në vendin tonë, përmes forcimit të menaxhimit me rreziqet dhe kontributit për zhvillimin e një sistemi të sigurtë dhe transparent pensional që e ka përkrahjen e anëtarësisë së publikut, si dhe përmirësimin e kapacitetit të MAPAS në drejtim të forcimit të rolit të tij mbikëqyrës dhe rregullues të sistemit pensional.

Anëtarët e Këshillit të ekspertëve dhe të gjithë nëpunësit në MAPAS e përkrahin realizimin e planit strategjik dhe vazhdimisht e ndjekin përparimin e realizuar në drejtim të qëllimeve të synuara në drejtim të realizimit të misionit për ditë më të sigurta pensionale për qytetarët e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Kryetari i Këshillit të Ekspertëve  
Maksud Ali

## Hyrje

Plani strategjik i MAPAS përcaktohet në bazë të misionit, vizionit dhe vlerave të MAPAS, duke marrë parasysh gjendjen ekzistuese në të cilën vepron MAPAS, ambientin e brendshëm dhe të jashtëm, si dhe sfidat kryesore. Plani strategjik përmban tre qëllime strategjike dhe gjashtëmbëdhjetë qëllime në aspekt të realizimit të qëllimeve kryesore për periudhën e ardhshme pesëvjeçare.

Plani strategjik vlerësohet për çdo vit dhe rishqyrtohet një herë në tre vite ose më shpesh nëse konstatohet një nevojë e atillë. Vlerësimi bëhet në bazë të indikatorëve/masave të definuar që vlerësohen në afat të shkurtë (një vit) dhe në afat të mesëm (pesë vite). Plani strategjik paraqet një bazë për planifikimin vjetor të aktiviteteve të MAPAS.

Në shtojcë të Planit strategjik për periudhën 2021-2025 janë:

1. Kornizë të mjeteve financiare për realizimin e planit strategjik për periudhën e viteve 2021-2025
2. Plani i veprimit për vitin 2021, masat për sukses dhe aktivitete, vlerësim të planit me rezultatet e realizuara (viti bazë 2019)

## Misioni

*MAPAS duhet të mbrojë interesat e anëtarëve dhe të anëtarëve të pensionuar të fondeve pensionale dhe ta nxit zhvillimin e sigurimit pensional me financim kapital, për ditë më të sigurta pensionale.*

## Vizioni

*MAPAS të spikatet si institucion i pavarur, profesional dhe transparent që e mbron dhe avancoon sigurimin pensional me financim kapital.*

## Vlerat

- **Profesionalizmi** - zbatimi i standardeve të pritshme nga një institucion profesional, në formë të besueshmërisë, diskrecionit, paanshmërisë dhe raportit të ndershëm në të gjitha sferat e veprimit e të tij.
- **Përgjegjësia** - marrja e përgjegjësisë për veprimet dhe për rezultatet e tyre
- **Puna ekipore** - punë e përbashkët për realizimin e qëllimeve tona dhe ndarjen e ideve dhe përvojave
- **Integriteti** - sigurimi i konsistencës, saktësisë dhe ndershmërisë gjatë realizimit të qëllimeve
- **Transparenca** - sigurimi i informimit në kohë dhe të qartë të opinionit për aktivitetet e MAPAS
- **Përkushtimi** - realizimi i përkushtuar i misionit dhe vizionit të MAPAS

# SISTEMI PENSIONAL NË MAQEDONINË E VERIUT

Sistemi pensional i Maqedonisë është pjesë e sigurimit social në Republikën e Maqedonisë. Ai ka strukturë të sistemit me tri shtylla me një mënyrë të kombinuar të financimit të pensioneve të ardhshme dhe diversifikimit të rreziqeve demografike dhe ekonomike, me qëllim të sigurimit të pensionit të sigurt për gjeneratat e ardhshme dhe të tanishme të pensionerëve dhe një stabilitet afatgjatë financiar të sistemit. Struktura e këtyre është rezultat i një reforme thelbësore të sigurimit pensional dhe invalidor që u përgatit ndër vite, ndërsa korniza e saj ligjore është krijuar në vitin 2000. Tri shtyllat e sistemit pensional të Maqedonisë janë:

- Shtylla e parë – sigurimi në bazë të solidaritetit të gjeneratave
- Shtylla e dytë – sigurimi i detyrueshëm pensional me financim kapital
- Shtylla e tretë – sigurimi vullnetar pensional me financim kapital

Shtylla e parë financohet në bazë rrjedhëse (PAYG), që nënkupton se me kontributet e të siguruarve ekzistues paguhen edhe pensionet e pensionistëve aktualë. Kjo shtyllë funksionon në bazë të parimit të a.sh. pensione të definuar, respektivisht përmes tij sigurohen pensionet sipas një formule të parapërcaktuar për përlogaritjen e pensionit. Nga shtylla e parë paguhet një pjesë e pensionit të pleqërisë, pensionit invalidor, pensionit familjar, si dhe shuma më e ulët e pensionit.

Shtylla e dytë dhe e tretë janë sigurimi pensional me financim kapital në të cilën bëhet kapitalizimi i kontributeve të paguara në emër dhe për llogari të anëtarit. Ato dy shtylla funksionojnë në parimin e a.sh. kontribute të definuara, respektivisht te ato përcaktohet paraprakisht niveli i kontributit që paguhet, ndërsa pensioni përcaktohet më pas, varësisht nga shuma e akumuluar. Nga shtylla e dytë paguhet një pjesë e pensionit të moshës. Nga shtylla e tretë sigurohet mbrojtje nga moshja, invaliditeti dhe vdekja.

Sigurimi pensional me financim kapital në mënyrë radikale dallohet nga sigurimi i financiar vijues pensional dhe në aspekt të trajtimit dhe evidencës së kontributeve të paguara dhe aspekt të përcaktimit dhe pagesës së pensionit. Në këtë sigurim secili anëtar ka llogari individuale ku evidentohen mjetet e tij dhe sigurohet lidhshmëri dhe varësi e ngushtë ndërmjet vëllimit të kontributeve të paguara dhe pensioneve të ardhshme që do t'i realizojë çdo person. Kjo mënyrë e sigurimit është e bazuar në parimin e akumulimit të mjeteve nga kontributet e llogarive individuale, që më tutje investohen dhe të ardhurat e realizuara nga investimet, të zvogëluara për shpenzimet e punës së sistemit, në tërësi shtohen në mjetet e akumuluar në llogaritë individuale. Pensioni i ardhshëm varet nga mjetet e akumuluar në llogarinë individuale dhe nga kohëzgjatja e pritshme e jetesës gjatë pensionimit, respektivisht periudhës së pritshme të shfrytëzimit të pensionit.

Institucionet që marrin pjesë në sistemin pensional janë:

- **Ministria e Punës dhe Politikës Sociale** – kompetente për krijimin dhe udhëheqjen e politikës së sigurimit pensional dhe invalidor dhe mbikëqyrje të realizimit të ligjshmërisë së atij sigurimi.
- **Agjencia për Mbikëqyrje të Financimit Kapital të Sigurimit Pensional (MAPAS)** - është institucion rregullator dhe mbikëqyrës, që i mbron interesat e anëtarëve dhe anëtarëve të pensionuar të fondeve pensionale, e rrit vetëdijen e publikut për karakteristikat e atij lloji të sigurimit dhe e nxit zhvillimin e sigurimit pensional me financim kapital.
- **Shoqëria pensionale** - shoqëri aksionare veprimtaria e vetme e së cilës është menaxhimi me mjetet e fondeve pensionale. Sistemi pensional në Maqedoni ka mundësi për themelimin e tri llojeve të shoqërive:
  - Shoqëri për menaxhim me fondet e detyrueshme pensionale
  - Shoqëri për menaxhim me fondet vullnetare pensionale
  - Shoqëri për menaxhim me fondet e detyrueshme dhe vullnetare pensionale

Në Republikën e Maqedonisë ekzistojnë dy shoqëri pensionale dhe secila prej tyre menaxhon me nga një fond të detyrueshëm dhe një vullnetar pensional. Të dy shoqëritë pensionale janë të themeluara nga aksionarë vendas (49% pjesëmarrje) dhe të huaj (51% pjesëmarrje), ndërsa dy shoqëritë tjera pensionale kanë aksionar të huaj (100% pjesëmarrje).

- **Ruajtësit e pronës së fondit pensional** - bankë e cila i ruan në mënyrë të sigurt mjetet e fondit pensional në llogari të posaçme, veçmas prej mjeteve të shoqërisë pensionale. Funkzioni i ruajtësit të pronës, edhe për fondet e detyrueshme por edhe ato vullnetare pensionale, është nën kompetencë të bankave afariste që kanë lidhur marrëveshje me shoqëritë pensionale, për ruajtjen e mjeteve të fondeve pensionale.
- **Drejtoria e të Ardhurave Publike (DAP)** - realizon arkëtimin e centralizuar të kontributeve dhe dorëzon deri te FSPIM kontributet e përgjithshme për sigurim pensional dhe invalidor.
- **Fondi i Sigurimit Pensional dhe Invalidor i Maqedonisë (FSPIM)** - bën shpërndarjen e kontributeve për sigurim pensional ndërmjet shtyllës së parë dhe të dytë dhe bën transferimin e kontributeve dhe të dhënave adekuate për anëtarët sipas fondeve të detyrueshme që i kanë përzgjedhur.



# AGJENCIA PËR MBIKËQYRJE TË FINANCIMIT KAPITAL TË SIGURIMIT PENSIONAL (MAPAS)

MAPAS është themeluar në korrik të vitit 2002 si organ mbikëqyrës dhe rregullator i financimit kapital të sigurimit pensional. MAPAS bën mbikëqyrje ndaj punës së shoqërive pensionale, fondeve pensionale dhe ruajtësve të pronës dhe miraton akte nënligjore dhe akte të tjera, me çka kontribuon për realizimin e plotë të ligjeve që e rregullojnë sigurimin pensional me financimin kapital.

Qëllimi themelor i MAPAS është që t'i mbrojtë interesat e anëtarëve dhe anëtarëve të pensionuar dhe të nxisë zhvillimin e sigurimit pensional me financim kapital në Republikën e Maqedonisë.

MAPAS është përgjegjës për dhënie, tërheqjen dhe shfuqizimin e lejeve për themelimin e shoqërive pensionale dhe të lejeve për menaxhim me fondet pensionale; bën mbikëqyrje të punës së shoqërive pensionale, fondeve pensionale si dhe të ruajtësve të pronës dhe të menaxhuesve të huaj të mjeteve. MAPAS bashkëpunon me Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale, Ministrinë e Financave, Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë, Komisionin për Letra me Vlerë, Agjencinë për Mbikëqyrje të Sigurimit dhe me institucione të tjera me qëllim të kontrollit dhe rregullimit të suksesshëm të sigurimit pensional me financim kapital në Maqedoni. Krahas raportit vjetor të punës, MAPAS përgatit edhe publikon raport vjetor për gjendjen e sigurimit pensional me financim kapital, si një prej mënyrave për sigurimin e transparencës së sistemit.


Për momentin, MAPAS i realizon funksionet e tij me gjithsej 28 të punësuar. Me MAPAS-in udhëheq dhe menaxhon Këshilli i Ekspertëve, i përbërë prej pesë anëtarëve (tre ekspertë të angazhuar profesionalisht dhe dy anëtarë të jashtëm), prej të cilëve njëri është kryetar. Struktura organizative e MAPAS është e përbërë prej sektorëve, seksioneve, departamenteve dhe revizionit të brendshëm.

- **Seksioni për marrëdhënie me publik dhe standardizim:** Seksioni kujdeset për: proceset e nevojshme për organizimin e sistemit të menaxhimit me kualitet, në mënyrë që të vendoset, realizohen dhe mirëmbahet sistemi për mbrojtjen e të dhënave personale në MAPAS, procedurën e sigurimit të qasjes së lirë në informatat me karakter publik, krijimin e mënyrës dhe procedurës për informimin e publikut, përpilimin e njoftimeve për medime, organizimin e konferencave për shtyp, planifikimin dhe realizimin e aktiviteteve për të ruajtur imazhin e mirë të MAPAS para publikut. Gjithashtu ky seksion është përgjegjës për organizimin dhe planifikimin e punëve dhe detyrave të kryetarit të Këshillit të Ekspertëve, anëtarëve të angazhuar profesional si dhe të anëtarëve të jashtëm. Për momentin, në këtë seksion punon një udhëheqës i seksionit dhe një udhëheqës i departamentit.

- **Sektori për Informatikë:** Sektori për informatikë në MAPAS kujdeset për mirëmbajtjen e vazhdueshme të zgjidhjeve ekzistuese lidhur me shtyllën e dytë dhe të tretë të sistemit pensional të Republikës së Maqedonisë, si dhe për zhvillimin e zgjidhjeve të reja softuerike në bashkëpunim me shtëpi të jashtme softuerike, për konsistencë të të dhënave në bazat e tyre, si dhe për vijimin e transferimit të të dhënave ndërmjet MAPAS-it dhe subjekteve me të cilat bashkëpunon. Sektori për Informatikë kujdeset edhe për mirëmbajtjen e serverëve si dhe pajisjeve të tjera harduerike me të cilat disponon MAPAS-i. Për momentin në këtë Sektor punojnë një udhëheqës sektori dhe një udhëheqës i seksioni.
- **Sektori për kontroll financiar (SKF):** Ky sektor bën kontroll financiar të fondeve pensionale dhe ruajtësve të pronës, në aspekt të kontrollit të procesit të transferimit të kontributeve nga momenti i dorëzimit të të dhënave në Fondin për SPIM deri në momentin e pagesës së tyre në fondet pensionale, kontroll të investimeve dhe vlerësimin e mjeteve të fondeve pensionale, si dhe kontroll të procesit të pagesës së pensioneve dhe kompensimeve pensionale në fondet pensionale. Për momentin në Sektorin për kontroll financiar punojnë dy udhëheqës të seksionit dhe një këshilltar.
- **Sektori për Kontroll Institucional:** Ky sektor bën kontroll të punës administrative, organizative dhe financiare të shoqërive pensionale. Udhëheq me Regjistrin e anëtarëve dhe vepron ndaj lëndëve që dalin nga anëtarësimet në fondet pensionale, respektivisht kontrollon procedurën e anëtarësimit, kalimit dhe realizimit të të drejtave të anëtarëve. Për momentin në Sektorin për kontroll institucional punon një udhëheqës i sektorit, një udhëheqës i seksionit, një këshilltar dhe një referent i lartë.
- **Sektori për Çështje Juridike:** Në kuadër të kompetencave të këtij sektori përgatiten aktet dhe dokumentet në lidhje me punën e MAPAS-it, realizohen procedurat e dhënies së lejeve dhe miratimeve për themelimin e shoqërive pensionale dhe fondeve pensionale, jepen leje për ndryshimet në shoqëritë pensionale dhe kryhen punët e resurseve njerëzore. Për momentin në këtë sektor punojnë një udhëheqës i sektorit, dy udhëheqës të seksioneve dhe një këshilltar.
- **Sektori për Hululumt dhe Bashkëpunim Ndërinstitucional:** Ky sektor ndjek dhe analizon sistemin pensional dhe bën hulumtime makroekonomike, përfshirë edhe përpilimin e raporteve statistikore dhe raporteve për gjendjen e sigurimit pensional me financim kapital, përpilon dhe përditëson programin për provimin për agjentë, propozimin e metodës për përllogaritjen e të ardhurave dhe ponderit dhe përllogaritjen e tyre, propozimin e metodologjisë për përllogaritje të pensioneve dhe analiza të tjera të reja të zhvillimi të sigurimit pensional me financim kapital. Gjithashtu ky sektor është përgjegjës edhe për ruajtjen e bashkëpunimit me institucionet me të cilat MAPAS ka nënshkruar memorandum bashkëpunimi. Momentalisht, në këtë sektor punojnë një udhëheqës i sektorit dhe dy udhëheqës të seksioneve.

- **Sektori për Çështje Financiare Administrative:** Ky sektor është përgjegjës për çështjet administrative dhe financiare që janë të domosdoshme për funksionimin pa pengesa të MAPAS, që përfshijnë përpunimin dhe realizimin e planit financiar të MAPAS, raportet e punës financiare, kontabilitetit, realizimit të procedurave për ndarjen e marrëveshjeve për prokurime publike, punës arkivore dhe çështje të tjera administrative. Për momentin në këtë sektor punojnë një udhëheqës i sektorit, dy udhëheqës të seksionit dhe dy referentë të lartë.
- **Revizioni i brendshëm:** Detyrat themelore të revizionit të brendshëm janë vlerësimi i faktorëve të rëndësishëm të rrezikut dhe dhënia e këshillave për Këshillin e ekspertëve të MAPAS për uljen e faktorëve të rrezikut; përcaktimi dhe vlerësimi i ekonomisë, efikasitetit dhe efektivitetit të punës së sistemeve për menaxhim dhe kontrolli financiar dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësimin e punës në bazë të analizave; kontrolli i saktësisë dhe kompletimit të evidencës së kontabilitetit dhe raporteve financiare; përcaktimi dhe vlerësimi i harmonizimit të punës sipas ligjeve, akteve nënligjore dhe akteve interne dhe ndjekjen e realizimit të masave të ndërmarra nga anëtarët e Këshillit të ekspertëve në MAPAS, në bazë të raportit të revizionit. Për momentin në revizion të brendshëm punon një revizor i brendshëm.

# ORGANIKA



<b>PJESËMARRËS KRYESORË</b>
<b>KLIENTË</b>
Anëtarët e fondeve pensionale
Shoqëritë pensionale
Ruajtësit e pronës së fondeve pensionale
<b>KLIENTË TË ARDHSHËM</b>
Qytetarët e Republikës së Maqedonisë
<b>PJESËMARRËS TË BRENDSHËM</b>
Të punësuarit në MAPAS
Këshilli i Ekspertëve në MAPAS
<b>PJESËMARRËS TANË TË JASHTËM</b>
Ministria e Punës dhe Politikës Sociale
Ministria e Financave
Qeveria e Republikës së Maqedonisë
Kuvendi i Republikës së Maqedonisë
Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë
Bursa e Maqedonisë
Komisioni për Letra me Vlerë
Agjencia për Mbikëqyrje të Sigurimit
Fondi i Sigurimit Pensionsal dhe Invalidor i Maqedonisë
Furnitorët
Konsulentët
<b>BASHKËPUNËTORË TANË NDËRKOMBËTARË</b>
Organizata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve Pensionalë - IOPS
Delegacioni i BE-së
Mbikëqyrësit pensionalë nga vendet e tjera
<b>PJESËMARRËS TJERË</b>
Mediat
Odat ekonomike dhe sindikatat

## Qëllimi strategjik 1:

*Sigurimi i menaxhimit me rreziqet që ju kërcënohen mjeteve dhe pensioneve e kompensimeve pensionale të anëtarëve të fondeve pensionale, si dhe dinjitetit të sistemit, duke i çuar ato në nivelin më të ulët të mundshëm*

Kursimi pensional është një investim afatgjatë që duhet të menaxhohet, duke ruajtur baraspeshën ndërmjet rrezikut dhe të hyrave që optimizohet gjatë ciklit jetësor të anëtarëve. Sistemi ekzistues imponon stimulime të fuqishme të shoqërive pensionale për arritjen e minimizimit afatshkurtër të paqëndrueshmëria që mund të arrihet vetëm nëse rriten rreziqet e tjera, siç janë p.sh. mospërshtatja e afateve (duration mismatch) dhe inflacionit, shikuar në afat më të gjatë, e që me të kufizohen edhe mundësitë për realizimin e të hyrave më të mëdha (të hyrat që mund të vendosen si qëllim ose që janë realizuar). MAPAS do të vazhdojë të punojë në drejtim të uljes së stimulimeve të atilla, me çka do të mundësojë zhvillimin e një qasje më intensive strategjike të investimit, me çka, si qëllim, do të vendoset të hyrat afatgjate dhe menaxhimi me rreziqet adekuate. Gjithashtu MAPAS do të angazhohet për transparencë më të madhe në aspekt të transformimit të asaj strategjie në procedura konkrete, si dhe për avancimin e procesit të menaxhimit me rreziqet. Kompensimet që arkëtohen nga ana e shoqërive pensionale, dukshëm ndikojnë dhe mund të ulin vlerën e pensioneve dhe kompensimeve pensionale në të ardhmen, me që arkëtohen gjatë periudhës së punës së anëtarëve, sepse ka rëndësi të veçantë që MAPAS edhe më tej të vazhdojë me zbatimin e qasjes së suksesshme për uljen e vazhdueshme të kufirit të skajshëm të kompensimeve për të ulur ndikimin e tyre.

## ***Qëllimi 1.1***

### ***Krijimi i kushteve për arritjen e niveleve maksimale të të ardhurave në periudhë afatgjate me një rrezik minimal, përmes promovimit të proceseve me kualitet të lartë për menaxhim me portfoliot investuese***

Në fillet e sistemit, derisa shoqëritë pensionale i zhvillonin kapacitetet dhe profesionalizmin, ishte e kuptueshme se minimizimi i paqëndrueshmërisë investuese do të jetë një iniciues i konsiderueshëm i sjelljes investuese. Në atë periudhë të hyrat reale ishin tejet të ulta dhe me planifikim afatshkurtër. MAPAS pret që shoqëritë pensionale të arrijnë pjekuri të funksionit investues, me çka në mënyrë aktive do të punojnë në arritjen e të hyrave me të larta që synohen nga investimet afatgjate dhe në pajtim me parimin e prurës, do të mbajnë një baraspeshë ndërmjet rrezikut dhe të hyrave. Ajo nënkupton se anëtarët e këshillave drejtues të shoqërive pensionale duhet ta bindin MAPAS si vijon:

- Vendimet që kanë të bëjnë me portfolion e fondit pensional janë të bazuara në analizë dhe këshilla me kualitet të lartë dhe adekuat.
- Fondet pensionale kanë për qëllim të hyra sa më të larta në afatgjatë, ndërsa realizimi i tyre bazohet në analiza paraprake;
- Në strategjinë investuese janë përshkruar veprimet afatgjate që do të ndërmerren, me qëllim të realizimit të të hyrave më të larta vetëm në dobi të anëtarëve dhe anëtarëve të pensionuar të fondit pensional edhe përmes diversifikimit dhe analizës financiare, me qëllim të minimizimit të rrezikut të humbjeve, që janë shkaktuar për shkak të mos pagesës së publikuesit ose palëve të tjera kontraktuese, që dalin nga ndikimi i tregjeve vendase dhe të jashtme financiare dhe që janë pasojë e shitjes së mjeteve të fondit pensional për shkak të sigurimit të likuiditetit të fondit pensional;
- Në bazë të strategjisë investuese, së paku një herë në vit për çdo fond pensional përpilohet një dokument për mënyrën e zbatimit të strategjisë investuese për 12 muajt e ardhshëm, që përmbajnë qëllime precize dhe hapësira të investimit sipas klasave të mjeteve, kufizimeve interne, paqëndrueshmërisë relative sipas klasave të mjeteve dhe ekspozimit ndaj rreziqeve;
- Të gjitha aktivitetet investuese janë në pajtim me dokumentacionin investues dhe çdo mospërshtatje me dokumentacionin investues mund të mënjanohet shpejtë;
- Personat e autorizuar për menaxhim me rreziqe, vazhdimisht i ndjekin rreziqet dhe raportojnë për rreziqet që i kërcënohen portfolios dhe ndërmarrin masa adekuate për minimizimin e tyre;
- Anëtarët e Këshillit Drejtues rregullisht i ndjekin rezultatet e investimit në bazë të analizave të detajuara, të përpiluara nga sektorët.

Në këtë drejtim, funksioni i MAPAS do të jetë që të punojë vazhdimisht me shoqëritë pensionale me qëllim që të sigurohen se ato zbatojnë politika adekuate dhe veprojnë drejtë me të dhe njëkohësisht e zvogëlon insistimin e tyre për planifikim në afat më të shkurtë.

MAPAS do t'i analizojë informatat që dalin nga raportet për portfoliot e fondeve pensionale dhe do të kontrollojë edhe në terren të gjitha proceset dhe politikat, në drejtim të konfirmimit se përparimi është i kënaqshëm dhe se shoqëritë pensionale punojnë sipas përvojave më të mira në sferën e investimit dhe se procedurat e tyre nuk dalin jashtë planeve të tyre investuese. Për të forcuar praktikën e mirë në këtë sferë, MAPAS do të kërkojë vërtetim nga shoqëritë pensionale se ndërmarrin veprime për zhvillimin e analizave, strategjive të tyre dhe menaxhimit me rreziqet dhe vërtetim për realizimin e tyre. Njëherë, MAPAS do t'u ndihmojë shoqërive pensionale për të pasur mirëkuptim për përvojat më të mira gjatë realizimit të obligimeve të asaj sfere. Ajo mund të realizohet edhe përmes seminareve, udhëzimeve dhe gjithsesi edhe përmes rregulloreve. Gjithashtu MAPAS do të angazhohet që përmes krijimit të një kornize të volitshme juridike dhe politike, si dhe përmes krijimit të kornizës institucionale, të strukturuar dhe streategjike t'i nxisë shoqëritë pensionale për ti integruar në punën e tyre edhe aspektet ekonomike, sociale dhe ekologjike.

MAPAS pret që shoqëritë pensionale në mënyrë të pavarur ta njohin nevojën për zhvillimin e proceseve zyrtare të punës, veçanërisht në drejtim të inkuadrimin të multifondeve, që vetvetiu kërkon një përsosmëri më të madhe. Gjithsesi, MAPAS, për t'i shmangur problemet e mundshme, do të propozojë ndryshime të rregullativës në aspekt të krijimit të bazës ligjore dhe nënligjore të funksionimit të multifondeve.

Investimi i mjeteve dhe sjellja e vendimeve investuese duhet të harmonizohet me parimin e prurës, me planet investuese vjetore dhe me menaxhimin me rreziqet. Kjo është edhe pjesë përbërëse e Qëllimit 1.4 që ka të bëjë me përmirësimin dhe avancimin e mbikëqyrjes dhe vlerësimit të rreziqeve të sistemit



### ***Promovimi i menaxhimit me kualitet të lartë dhe menaxhimi me rreziqet e shoqërive pensionale për të siguruar minimizimin e rreziqeve***

Rreziqet në shoqëritë pensionale do të ulen ose ruhen në nivel të ulët nëse ekzistojnë kontrolle që me rregull zbatohen dhe nëse shoqëritë kanë krijuar politika përkatëse për realizimin efektiv të obligimeve ndaj anëtarëve të fondeve pensionale. Ajo do të arrihet në veçanti nëse shoqëritë pensionale kanë metoda të suksesshme për menaxhim me rreziqet. Një pjesë e obligimit fiducijar të këshillave drejtuese të shoqërive pensionale është që ato të sigurojnë se janë krijuar të gjitha kontrollet e nevojshme dhe se vendimet sillen në mënyrë objektive, në bazë të argumenteve të mjaftueshme dhe kuptimit të rrezikut, duke e përjashtuar mundësinë e paraqitjes së konfliktit të interesave.

MAPAS do ta forcojë atë porosi duke ua definuar qartë obligimet e shoqërive pensionale dhe do ta kontrollojë realizimin e tyre. Prioriteti për përmirësimin e menaxhimit korporativ të shoqërive pensionale është që të kenë mundësi të tregojnë se janë të harmonizuara në tërësi me kontrollin e brendshëm dhe rregulloret si dhe ta zhvillojnë funksionin e menaxhimit me rreziqet. Pikërisht për këtë, MAPAS do të kërkojë nga shoqëritë pensionale që të dorëzojnë vërtetime vjetore se kanë krijuar procedura adekuate për menaxhim korporativ. Pastaj MAPAS do ta kontrollojë respektimin dhe përshtatjen e tyre me qëllim që të sigurohet se shoqëritë pensionale nuk e kanë informuar gabimisht MAPAS.

Pasi që do të sigurohet se sistemi i menaxhimit në shoqëri është përkatës, atëherë MAPAS do të jetë me efikas në punën e tyre sepse një pjesë e përgjegjësive për proceset kyçe kontrolluese dhe do t'u dorëzohet shoqërive. Ajo mund të ndodh vetëm atëherë kur MAPAS do të ketë mjaftë besim në menaxhimin e shoqërive pensionale, që në fakt paraqet edhe në arsye shtesë që MAPAS t'i forcojë porositë për shoqëritë në atë drejtim.

Sigurimi i standardeve të larta të menaxhimit korporativ dhe menaxhimit me rreziqe nënkupton që MAPAS të thotë qartë për shoqëritë pensionale që në fakt prej tyre pritet pëlqim në këtë drejtim. Kjo mund të bëhet përmes Kodit për menaxhim korporativ, që paraqet një pikënisje të mirë. Pastaj, MAPAS do ta kontrollojë implementimin dhe do t'u propozojë shoqërive pensionale për largimin e parregullsive, e tërë kjo duke shtuar mundësinë për inicimin e masave të shkallës më të lartë nëse shoqëritë nuk harmonizohen me kërkesat e MAPAS.

### ***Punë për uljen e vazhdueshme të ndikimit që e kanë kompensimet që i arkëtojnë shoqëritë pensionale të pensionave të anëtarëve të fondeve pensionale me cka do të sigurojë që kompensimet të jenë pasqyrë e një sistemi efikas i sigurimit pensional me financim kapital***

Në pajtim me ligjin për sigurim pensional me financim të detyrueshëm kapital dhe Ligjin për sigurim pensional me financim vullnetar kapital, shoqëritë pensionale arkëtojnë kompensime nga kontributet dhe mjetet dhe kompensimet e transferimit. Arkëtimi i kompensimeve është i domosdoshëm me qëllim që shoqëritë pensionale të mund t'i kryejnë funksionet e tyre të menaxhimit me fondet pensionale. Për realizimin e funksioneve dhe aktiviteteve të tyre të kompensimit, shoqëritë pensionale arkëtojnë nga ruajtësit e pronës, MAPAS dhe Fondi i SPIM, që krahasuar me vitet e fillimit të punës së sistemit, janë më të ulta dhe dukshëm janë ulur me rritjen e sistemit.

Shumat e larta dukshëm mund të ndikojnë në vlerën e pensioneve të ardhshme dhe për këtë duhet të ruhen në nivelin minimal, që u mundëson shoqërive pensionale që të realizojnë të hyra adekuate në aspekt të shpenzimeve që i realizojnë. Në Republikën e Maqedonisë së Veriut nuk ekziston konkurrencë e mjaftueshme ndërmjet shoqërive pensionale (edhe pse në vitin 2019 filloi me punë edhe shoqëria e tretë pensionale) për t'u arritur ato efekte, por edhe përvoja ndërkombëtare dëshmoi se konkurrenca si faktor nuk ka arritur ndikim të konsiderueshëm për uljen e kompensimeve. Për këtë, shumat maksimale të kompensimeve përcaktohen me ligj.

Procesi i përcaktimit të shumës maksimale të kompensimeve duhet të jetë objektiv dhe i drejtë për të gjitha palët e përfshira dhe në këtë drejtim të shmanget ndikimi eventual politik. Së këndejmë del edhe roli kyç i MAPAS si institucion profesional për përcaktimin e shpenzimeve të domosdoshme për punë të suksesshme të shoqërisë pensionale dhe të japë këshilla në drejtim të uljeve të ardhshme të shumës maksimale të kompensimeve. Shumat maksimale të kompensimeve duhet të përcaktohen në shkallë të rënies dhe mjaftueshëm prej përpara për të nxitur kontrollë të rrepta të shpenzimeve të shoqërive pensionale. Kjo ishte siguruar edhe me ndryshime të Ligjit për sigurim pensional me financim të detyrueshëm kapital në vitin 2013, kur edhe u përcaktua shuma maksimale e kompensimit nga kontributet dhe kompensimi të mjeteve që mund të arkëtohen nga shoqëritë pensionale të shtyllës së dytë.

Gjithashtu edhe në ligjin për sigurim pensional me financim vullnetar kapital janë përcaktuar shumat maksimale të kompensimit të kontributeve dhe kompensimit të mjeteve që mund t'i arkëtojnë shoqëritë pensionale të shtyllës së tretë. Kompensimet e shoqërive pensionale realisht arkëtohen në shtyllën e tretë janë më të ulta se sa ato maksimalet e përcaktuara me ligj dhe që ishin ulur nga ana e shoqërive pensionale disa herë.

MAPAS edhe më tutje do të vazhdojë me ndjekjen dhe kontrollin nëse shpenzimet e krijuara për të cilat paguhet drejtpërdrejtë nga anëtarët ose nga të hyrat e shoqërive pensionale janë ligjore dhe të arsyeshme.

## ***Qëllimi 1.4***

***Përmirësimi dhe avancimi i kornizës për mbikëqyrje të shoqërive pensionale, fondeve pensionale dhe ruajtësve të pronës në bazë të vlerësimit të bërë të rreziqeve të sistemit.***

Për t'u siguruar menaxhimi me rreziqet dhe minimizimi i tyre, MAPAS i nevojiten procese me ndihmën e të cilëve do të identifikohen dhe vlerësohen rreziqet në mënyrë strukturore prej ku do të merren informata për atë se çfarë prioritete dhe çfarë testimesh duhet të zbatohen për secilin rrezik dhe çfarë masa shtesë duhet të ndërmerren. Kështu, resurset mund të orientohen drejt këtyre rreziqeve për të cilat ekziston një probabilitet i madh se do të ndikojnë në pensionet e ardhshme të anëtarëve dhe të qëndrueshmërisë së sistemit. Gjithashtu, resurset do të orientohen edhe aty ku rreziku ka përfshirje më të madhe dhe duhet të zbutet, në këtë drejtim duke i ndihmuar edhe MAPAS për të përgatitur dhe propozuar ndryshime me të cilat mund të ulet nivel i rrezikut.

Komiteti për vlerësimin e rreziqeve e koordinon procesin e identifikimit dhe vlerësimit të rreziqeve, njëherë në pjesën e kontrollit të terrenit dhe jashtë tij, i shqyrton duke propozuar përmirësimin e metodave për vlerësimin e rreziqeve.

Në drejtim të forcimit të mbikëqyrjes është miratuar edhe një Rregullore për mbikëqyrje të bazuar në rreziqe dhe i njëjti do të rishqyrtohet sipas nevojës.

## **Qëllimi strategjik 2:**

### ***Zhvillimi dhe mirëmbajtja e sigurimit pensional stabil dhe transparent me financim kapital, që e ka përkrahjen e anëtarësisë dhe publikut***

Sigurimi pensional me financim kapital paraqet një element tejet të veçantë në kuadër të mekanizmave që qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut mund t'u kontribuojnë për sigurimin e sigurisë financiare pas pensionimit të tyre. MAPAS do të vazhdojë që ti ndjek gjendjet në sferën pensionale, të ndërmarrë aktivitete për avancimin e sigurimit pensional me financim kapital dhe të sigurojë kushte për punë efikase të sigurimit pensional me financim kapital. Pastaj MAPAS do të insistojë për rregulla të implementimit të procedurave të ardhshme ligjore që kanë të bëjnë me multifondet dhe që kanë rëndësi të posaçme për optimizimin e portfoliove. Pronarët e fondeve pensionale janë anëtarët dhe pikërisht për këtë ka rëndësi të veçantë ekzistimi i përgjegjësisë dhe transparencës gjatë menaxhimit të fondeve pensionale, ashtu edhe gjatë rregullimit dhe mbikëqyrjes së sigurimit pensional me financim kapital. Anëtarët dhe anëtarët e pensionuar duhet të kenë qasje të shpejtë deri te informatat që kanë të bëjnë me llogaritë e tyre dhe punën e sistemit. Sigurimi pensional me financim kapital dukshëm dallohet nga shtylla e parë që është e njohur për qytetarët. Ka shumë rëndësi që anëtarët dhe publiku të kenë një pasqyrë të qartë për atë se si funksionon sigurimi pensional me financim kapital dhe cilat janë përfitimet për anëtarët e tyre. Qëndrueshmëria e sistemit, në masë të madhe varet edhe nga ajo se si ai do të kuptohet nga ana e anëtarësisë dhe publikut, si dhe nga përkrahja që i jepet. MAPAS luan një rol kyç në realizimin e këtij qëllimi.

### ***Avancimi i vazhdueshëm i sigurimit pensional me financim kapital dhe sigurimi i kushteve për punë efikase të subjekteve nën mbikëqyrje***

Sigurimi pensional me financim kapital si pjesë e sistemit pensional të Republikës së Maqedonisë së Veriut ka efekte pozitive në aspekt të sigurimit të stabilitetit afatgjatë të sistemit pensional dhe sigurisë gjatë realizimit të të drejtave nga sigurimi pensional. Koncepti i kursimit individual të mjeteve për pension, si një prej burimeve të të hyrave të ardhshme pas pensionimit, ka natyrë afatgjate, ndërsa sfidat që i sjell sigurimi pensional me financim kapital janë të pashmangshme. MAPAS viteve të ardhshme do të vazhdojë në vijim me përcjelljen dhe analizën e vazhdueshme të gjendjeve në sferën pensionale, e me këtë do të vazhdohet të ndërmerren aktivitete dhe masa përkatëse për avancimin e sigurimit pensional me financim kapital, me qëllim të forcimit të kursimeve individuale për pensionin e ardhshëm përmes promovimit të menaxhimit efikas dhe fleksibil me portfoliot dhe sigurimin e kushteve për rritjen e pjesëmarrjes së popullsisë në shtyllën e dytë dhe të tretë.

Të gjitha aktivitetet në drejtim të avancimit të sigurimit pensional me financim kapital janë të rregulluara. Si trup rregullator, me kompetenca për të propozuara ligje dhe për të miratuar akte nënligjore për rregullimin dhe avancimin e sigurimit pensional me financim kapital, MAPAS ka rol primar në avancimin e sigurimit pensional me financim kapital, e me këtë njëkohësisht është kyçur në përpjekjet për funksionimin e suksesshëm të mbrojtjes së shtetit juridik. Rregullat janë bazë të çdo shteti ligjor me çka është përcaktuar edhe renditja juridike, është rregulluar funksionimi i subjekteve dhe raportet e tyre të ndërsjella juridike. Për sundimin e të drejtës dhe funksionimit të denjë të shtetit si shtet ligjor, parakusht themelor është rregullat e krijuara. Përmbajtja e rregullave mund të jenë të kuptueshme, pa hamendje, të përdorueshme dhe të zbatueshme. Niveli i këtillë i rregullave mund të arrihet vetëm nëse rregullat janë të përgatitura në aspekt nomoteknik, që nënkupton se duhet të jenë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjet, të miratohen nga organet kompetente dhe sipas procedurës së përcaktuar. Gjatë realizimit në praktikë, rregullat e keq përgatitura shkaktojnë një sërë vështirësish dhe problemesh dhe e ulin sigurinë ligjore dhe besimin në drejtësinë dhe shtetin ligjor.

Në këtë drejtim MAPAS gjatë viteve në vijim do të vazhdojë t'i realizojë kompetencat e veta rregulluese, respektivisht të propozojë dhe miratojë rregulla për sigurimin pensional të financuar kapital, në bazë të:

- ndjekjes së proceseve dhe gjendjeve aktuale të sigurimit pensional me financim kapital, në sistemin pensional dhe sektorin financiar të shtetit,
- ndryshime të ligjeve dhe sferave të tjera (shoqërive tregtare, kundërvajtjeve, digjitalizimit, mbrojtjes së të dhënave personale, parandalimit të larjes së parave dhe financimit të terrorizmit, etj.)
- harmonizimi i ë drejtës (acquis) së BE-së dhe
- përvojat, praktikat dhe rekomandimet ndërkombëtare (BB, IOPS, OECD, FSAP, etj.)

Gjithashtu, MAPAS do të vazhdojë me propozimin e ndryshimeve ligjore edhe në fushat e tjera që kanë ndikim në stabilitetin dhe avancimin e sigurimit pensional me financim kapital.

Shoqëritë pensionale dhe fondet pensionale janë të bazuara dhe punojnë në bazë të lejeve/pëlqimeve nga MAPAS në procedurë të rregulluar dhe kushte të rrepta. Me qëllim të ruajtjes së kushteve për punë efikase të shoqërive pensionale dhe fondeve pensionale si dhe të ruajtësve të pronës, MAPAS do të vazhdojë me zbatimin e procedurave të miratimit të dokumenteve dhe personave (anëtarëve të këshillave drejtues dhe mbikëqyrës dhe personave përgjegjës për sfera të caktuara) që ishin miratuar gjatë procedurës së licencimit, e që nevojitet të ndryshohen.

Në vitin 2020, MAPAS u kyç në angazhimin e përbashkët me rregullatorët financiar, të udhëhequr nga BPRMV, për identifikimin në kohë dhe efikas të rreziqeve të sistemit dhe në ndërmarrjen e aktiviteteve për parandalimin dhe uljen e ndikimit të tyre ndaj sistemit financiar. Me këto aktivitete gjithashtu do të forcohet në mënyrë shtesë edhe rezistenca e sistemit financiar ndaj befasive, ndërsa institucionet kompetente do të jenë edhe më të përgatitura për avancimin drejt sfidave. MAPAS në vitet në vazhdim do të punojë për ndërtimin e kapacitetit të vet për zbatimin e këtyre aktiviteteve, si dhe për aktivitetet në drejtim të zbatimit të politikës makroprudente, përcaktimit të instrumenteve makroprudente dhe ndërmarrjen e masave makroprudente ndaj subjekteve që janë lëndë e mbikëqyrjes.

Zhvillimi ekspansiv i teknologjisë do ta transformojë shpejtë mënyrën në të cilën funksionon sektori financiar, përfshirë edhe sektorin pensional. Duke marrë parasysh ndërlikueshmërinë e sigurimit pensional me financim kapital, disa prej teknologjive inovative (si aplikacionet celulare dhe platformat interaktive me publikime digjitale) mund ta lehtësojnë qasjen deri te informatat kyçe pensionale në kohë reale dhe njëkohësisht t'u mundësojë të siguruarve që më mirë t'i planifikojnë dhe menaxhojnë kursimet e tyre pensionale. Për këtë, në vitet në vijim, MAPAS do t'i orientojë aktivitetet e veta edhe ndaj përpjekjeve për të

shfrytëzuar teknologjinë për përmirësimin e kualitetit dhe “dërgesës” së shërbimeve dhe informatave nga shoqëritë pensionale dhe si rregullatorë do të nxisë edhe përkrah këto ndryshime. Si aktivitet fillestar në këtë drejtim, duke marrë parasysh kapacitetet dhe resurset e tanishme të MAPAS, do të kyçen edhe aktivitete që dalin nga qendra e inovacioneve që është krijuar nga BPRMV. Pastaj, MAPAS do të kyçet në mënyrë aktive edhe në aktivitetet e përbashkëta edhe me pjesëmarrësit dhe rregullatorët e tjerë të sektorit financiar, e që udhëhiqen nga BPRMV dhe janë në drejtim të rritjes së vetëdijes për rëndësinë e teknologjive të reja, rreziqeve dhe përfitimeve nga zbatimi i tyre, në sigurimin pensional me financim kapital si pjesë e sektorit financiar. Një prej këtyre aktiviteteve është edhe inkuadrimi për përpilimin e një strategjie të posaçme për zbatimin e teknologjive financiare.

Paralelisht paraqitet edhe nevoja për detektimin e rreziqeve që mund të krijohen për zhvillimin e teknologjive financiare, si p.sh sulmeve kibernetike, keqpërdorimit të mjeteve pensionale, ndërmarrjen e të dhënave dhe informatave personale, etj. Për këtë arsye inovacionet në sigurimin pensional me financim kapital duhet të jenë një sferë me vëmendje të shtuar të mbikëqyrjes.

Pastaj, teknologjitë inovative kanë potencial për të thjeshtësuar dhe përmirësuar si funksionin rregullues edhe atë mbikëqyrës, përmes rritjes së efikasitetit të procedurave administrative, lehtësimin e komunikimit ndërmjet subjekteve të mbikëqyrura dhe mbikëqyrësve, racionalizimin e proceseve të informimit dhe automatizimin e proceseve për grumbullimin e të dhënave, automatizimin e analizimit të të dhënave të grumbulluara, zhvillimin e platformave teknologjike për lehtësimin e mbikëqyrjeve në terren, etj.

Në këtë drejtim të zhvillimit të teknologjisë dhe ndikimit ndaj sektorit pensional, është e domosdoshme lehtësimi i njohurive ekzistuese, sigurimin e ekspertizës dhe mjeteve teknologjike dhe zgjidhjeve për zhvillimin e projekteve digjitale në MAPAS.



### ***Krijimi dhe promovimi i portfoliove të ndryshme investuese në bazë të moshës së anëtarëve të fondeve pensionale dhe të gjitha mundësive që i kanë anëtarët, e që do të mundësojnë kyçje të multifondeve***

Aktualisht çdo shoqëri pensionale menaxhon me nga një fond të detyrueshëm dhe një vullnetar pensional. Parimi i një njeriut racional imponon që fondet pensionale të optimizohen për t'u përshtatur ndaj rrethanave specifike të secilit anëtar. Më konkretisht, kohëzgjatja optimale e instrumenteve financiare varet nga koha e mbetur deri në pensionim, si dhe nga shkalla që anëtarët mund të ekspozohen ndaj paqëndrueshmërisë së tregut pa pësuar humbje që nuk mund të kompensohen para periudhës së pensionimit. Në fakt, mundësia se paqëndrueshmëria e tregut mund të shkaktojë ndikim serioz ndaj mjeteve të akumuluarra të anëtarëve para pensionimit, paraqet një prej shtyllave të planifikimit të investimit në pajtim me periudhën e pensionimit të anëtarëve.

Zgjidhja më e pranueshme dhe më e rekomanduar ndërkombëtare për këtë problem është investimi strategjik i mjeteve të anëtarëve, nisur nga koha e mbetur deri në pensionim (ndjekja e ciklit jetësor).

Në këtë drejtim, praktika tregon se vendimet për ndryshime në investimin e mjeteve janë të lidhura me moshën, që nuk nënkupton me doemos se edhe do të përshtaten me rrethanat specifike të anëtarit. Për këtë, zakonisht jepet mundësi që anëtari të zgjedhë një portfolio, për të shmangur vendimet për investimin e mjeteve, që në të kundërtën do të shtoheshin ndaj mjeteve të tija.

Në vendet që kanë sistem të ngjashëm me sistemin pensional maqedonas, "multifondet" shfrytëzohen si një metodë standarde për investim sipas ciklit jetësor me të cilin anëtarëve u jepet mundësia e zgjedhjes. Kështu, është në sigurimin pensional me financim të detyrueshëm dhe atë vullnetar, do të mundësohet ekzistimi i tri portfoliove pensionale që do të dallohen për nga mënyra e investimit të mjeteve dhe, përkatësisht me këtë, anëtarët e fondit pensional do të mund të zgjedhin një portfolio pensionale. Njëherë, struktura e anëtarësisë e imponon nevojën për shtimin e multi fondeve në bazë të portfoliove të ndryshme (agresiv, i balancuar dhe konservator) sipas strukturës së moshës së anëtarëve.

Anëtarët që nuk do të zgjedhin vetë portfolio, do të transferohen automatikisht në një portfolio që i përshtatet moshës së tyre. Pas ndryshimit të akteve adekuate ligjore dhe nënligjore, do të pasojë një periudhë kalimtare për

harmonizimin e investimit të mjeteve. Qëllimi i shtimit të tri llojeve të porfoliove është rritja e pensionit të ardhshëm nga shtylla e dytë pensionale, për të përmirësuar sigurinë gjatë investimit të mjeteve, duke marrë parasysh kushtet e ndryshueshme të rrezikut, sigurinë dhe likuiditetin adekuat të fondeve pensionale gjatë rrugës jetësore të anëtarëve dhe rritjen e diversifikimit të mundësive të investimit.

MAPAS, shoqëritë pensionale dhe ruajtësit e pronës do ta forcojnë kapacitetin personal për të implementuar multifondet. MAPAS do të kontrollojë shkallën e zhvillimit të kapaciteteve të shoqërive për të përcaktuar nëse ato janë në nivelin e duhur dhe nëse janë në pajtim me funksionin që e kryejnë. Njëkohësisht, MAPAS do të kontrollojë edhe menaxhimin me rreziqet që i kërcënohen sistemit, e që dalin nga shtimi i multifondeve. Në bashkëpunim me Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale, MAPAS do të kujdeset për implementimin adekuat të kësaj risie, duke e shtuar edhe përgatitjen e rregulloreve adekuate.

### ***Sigurimi i vazhdueshëm i transparencës së sigurimit pensional të financuar kapital dhe sqarimi i karakteristikave, mundësive dhe përparësive të sigurimit pensional të financuar kapital, më mënyrë të qartë dhe të kuptueshme për qytetarët***

Gjatë ekzistimit të sistemit pensional me ti shtylla, e në pajtim me hulumtimet e realizuara të mendimit publik të anëtarëve të fondeve pensionale, është konstatuar një lëvizje e caktuar pozitive e nivelit të njohurive të përgjithshme të publikut lidhur me karakteristikat dhe përparësitë e sigurimit pensional të financuar kapital dhe për rolin e MAPAS në sistemin pensional. Prapë se prapë, për MAPAS si rregullator dhe mbikëqyrës edhe më tutje mbetet perceptimi se ky nivel i vetëdijes publike nuk mjafton, veçanërisht sepse personat kanë rol personal përmes vendimeve, respektivisht në përgjithësi kanë të drejtë dhe liri të zgjedhjes, në të gjitha fazat e kursimit pensional – anëtarësimit, akumulimit dhe pagesës. Në vitin 2020, kur bota u ballafaqua me pandeminë e koronavirusit dhe me krizë globale financiare, u theksua nevoja edhe më e madhe për vetëdije më të lartë të publikut. Gjithashtu, ambienti i ri dikton edhe një zhvillim të përshpejtuar të teknologjisë e cila e transformon shpejtë mënyrën e funksionimit të sektorit financiar, përfshirë edhe sektorin pensional, që do të mundësojë një qasje më të thjeshtë deri te sigurimi pensional i financuar kapital nga njëra anë, por edhe një rritje të shtuar të edukimit nga ana tjetër.

Për këtë, zhvillimi i vetëdijes së publikut për qëllimet dhe parimet e sigurimit pensional të financuar kapital edhe më tutje mbeten një prej sfidave kryesore të MAPAS. Ngritja e vetëdijes së publikut dhe rritja e përkrahjes së sigurimit pensional të financuar kapital në kuadër të sistemit pensional, do ta përforcojë avancimin e sistemit, e njëherë edhe do ta ul edhe mundësinë e paraqitjes së situatave të paparashikuara në afat më të gjatë. Roli i MAPAS që është rregulluar me ligj dhe nënkupton përgjegjësi për aktivitetet personale dhe mundëson që MAPAS të marrë rolin udhëheqës për rritjen e nivelit të vetëdijes publike.

MAPAS do të sigurojë publikimin në kohë dhe të rregullt, si dhe shpërndarje të të dhënave dhe informatave të detajuara për sigurimin pensional të financuar kapital, përmes raporteve për gjendjet e sigurimit pensional të financuar kapital dhe të raporteve statistikore. Me këtë sigurohet transparencë të sigurimit pensional të financuar kapital dhe një bazë e mirë për shpërndarjen e mëtutjeshme të informatave përmes kanaleve të ndryshme të komunikimit. MAPAS gjatë viteve në vijim do të vazhdojë të punojë edhe me avancimin e raporteve të sigurimit pensional të financuar kapital si dhe përmes avancimit

kualitativ dhe kuantitativ të të dhënave, kështu edhe përmes mundësimit të një qasje më të thjeshtë deri te këto të dhëna për publikun e gjere.

MAPAS, në kuadër të kompetencave të veta për zhvillimin e vetëdijes së publikut për qëllimet dhe parimet e sigurimit pensional të financuar kapital dhe të drejtave të anëtarëve të fondeve pensionale, do të vazhdojë me edukimin e anëtarëve dhe publikut, veçanërisht të personave të rinj, me qëllim të rritjes së vetëdijes dhe informimit për të siguruarit në lidhje me sistemin. Gjithashtu, MAPAS do të vazhdojë të punojë edhe në avancimin e aktiviteteve që do të kontribuojnë për rritjen e vetëdijes pensionale te publiku, duke e përshtatur me grupet e synuara, trendët dhe risitë që dalin nga zhvillimi i teknologjisë në komunikimin me publikun.

Nga viti 2016, MAPAS filloi me shënimin e “Ditës së vetëdijes pensionale – 15 shtatorit” përmes organizimit të konferencave para trupave rregullues, institucioneve shtetërore, bashkëpunëtorëve dhe mysafirëve nga vendi dhe jashtë, si dhe përmes ngjarjeve informative argëtuese. Nga viti 2019, MAPAS filloi me realizimin e fushatës informative për edukimin dhe informimin e anëtarëve të fondeve pensionale për sistemin pensional. Gjatë vitit 2020 u realizua një fushatë informative: “Nëse është herët pension nuk është herët për penzija.mk”, që organizohej përmes internetit, si dhe mënyra të tjera të komunikimit me grupet e synuara për zgjidhjet e reja kreative, me qëllim që të vazhdohet me kontributin për rritjen e vetëdijes së publikut për përfitimet e shtimit të sistemit pensional me tre shtylla. MAPAS edhe në pesë vitet e ardhshme do të vazhdojë me organizimin e aktiviteteve për shënimin e ditës së vetëdijes pensionale dhe për realizimin e fushatave informative. Më pas, një pjesë e aktiviteteve për informimin e publikut do të realizohen me angazhimin e përbashkët të shoqërive pensionale. Gjithashtu, një pjesë e aktiviteteve të MAPAS do të orientohen edhe drejt promovimit të rëndësisë dhe rolit të MAPAS.

Nga dhjetori i vitit 2013, MAPAS është aktive edhe në angazhimin e përbashkët të institucioneve rregulluese financiare në aspekt të edukimit financiar, si pjesë e Trupit koordinues për edukim financiar dhe inkluzion financiar. MAPAS edhe në vitet e ardhshme do të vazhdojë me pjesëmarrje në punën dhe aktivitetet e shumta të këtij trupi, që përfshinë edhe pjesëmarrje në përpunimin e strategjisë kombëtare për edukim financiar dhe inkluzion financiar, që duhet të kontribuojë për ndërtimin e mëtejme të kapaciteteve për zhvillimin e edukimit financiar dhe avancimit të mëtejme të inkluzionit financiar të popullsisë.

Duke marrë parasysh faktin që edhe pas më shumë se dhjetë viteve punë të shtyllës së tretë, pjesëmarrja e popullsisë në shtyllën e tretë ende nuk i ka arritur pritshmërinë, MAPAS në vitet e ardhshme do t’i kushtojë vëmendje të veçantë aktiviteteve promovuese, me qëllim të rritjes së pjesëmarrjes në shtyllën e tretë, njëherë duke i nxitur në këtë drejtim edhe

shoqëritë pensionale. Krahas kësaj në periudhën e ardhshme, MAPAS do të angazhohet për mundësimin e rregullave më të thjeshta dhe uljen e kufizimeve për inkuadrimin e popullsisë në fondet pensionale vullnetare si në bazë të iniciativave personale, ashtu edhe përmes iniciativave të punëdhënësve ose shoqatave të qytetarëve, si sponsorë të skemave profesionale pensionale.

MAPAS edhe në të ardhmen do të kontribuojë për ngritjen e vetëdijes së publikut për përmirësimin e njohurive për sistemin, si dhe promovimin e sigurimit pensional të financuar vullnetar kapital.

### ***Avancimi i kualitetit të informatave që u dorëzohen anëtarëve të fondeve pensionale në lidhje me të drejtat, obligimet dhe interesat e tyre, me qëllim të ndërtimit të besimit në sistem dhe në mënyrë transparente dhe efikas të përmbushen kërkesat e anëtarëve***

Hulumtimet e realizuara të mendimit publik dhe të komunikimit të përditshëm me anëtarët e fondeve pensionale dhe publikut, tregojnë se ekziston një lëvizje e caktuar pozitive e nivelit të njohurive për sigurimin pensional të financuar kapital dhe sistemit pensional gjatë viteve të ekzistimit të sistemit pensional me tre shtylla. Prapë se prapë MAPAS vlerëson se njohja e pjesës më të madhe të anëtarëve të fondeve pensionale është ende në një nivel joadekuat dhe se kjo mund të kontribuojë në ekspozimin e anëtarëve ndaj konkluzioneve të gabueshme në lidhje me pensionet e tyre të ardhshme, që mund të sjellë vendime që nuk janë optimale dhe deri te dëshpërime të paarsyeshme. Gjithashtu vlerësohet se anëtarët ende nuk dinë se çfarë të presin nga shoqëritë e tyre pensionale, çfarë mbrojtje është paraparë për pensionet e tyre të ardhshme, e as se kush është përgjegjës për sigurimin e saj. Pikërisht për këtë, roli i MAPAS është që të kontribuojë për kuptimin e drejtë të sigurimit pensional të financuar kapital, nga ana e anëtarëve..

MAPAS do të vazhdojë që me kujdes ta ndjekë njohjen e anëtarëve për të drejtat dhe obligimet e tyre, do të vazhdojë të sigurojë kushte për avancimin e kualitetit të informatave dhe për forcimin e kanaleve komunikuese me anëtarët. MAPAS do të vazhdojë që të sigurojë informata për personat që veç më janë anëtarë edhe atë me kërkesë të tyre të drejtpërdrejtë, përfshirë edhe informatat për shpërndarjet e tyre në fondin e detyrueshëm pensional.

MAPAS siguron një veprim të rregullt dhe në kohë ndaj parashtresave (ankesave, vërejtjeve, kërkesave) të anëtarëve në baza të ndryshme. Me këtë sigurohet një veprim efikas ndaj kërkesave të anëtarëve të fondeve pensionale që kontribuon në rritjen e besimit të sistemit. MAPAS do të vazhdojë që edhe në të ardhmen të veprojë rregullisht dhe në kohë ndaj parashtresave të anëtarëve të fondeve pensionale.

MAPAS do të inkuadrohet edhe në aktivitete për mbrojtjen e konsumatorëve në kuadër të grupit të punës së MF.

Aktivitetet e marketingut dhe shitjes të shoqërive pensionale gjithashtu ndikojnë në përmirësimin dhe kuptimin e sigurimit pensional të financuar kapital te anëtarët dhe anëtarët potencial, por ato aktivitete nëse nuk janë mirë të rregulluara dhe të kontrolluara, mund t'i habisin qytetarët, gjë që mund të ndikojë në uljen e besimit ndaj sistemit. Së këndejmë, MAPAS do të vazhdojë të sigurojë

kushte në të cilat shoqëritë pensionale me sukses do t'i realizojnë dhe kontrollojnë aktivitetet e tyre të marketingut dhe do të sigurojë zgjidhjen e problemeve që do të paraqiten. Gjithashtu, MAPAS do të vazhdojë me kontrollimin e mënyrës se si komunikojnë shoqëritë pensionale me anëtarët, veçanërisht në fazën e dhënies së informatave kur anëtarët aderojnë në një fond të caktuar pensional.

### ***Mirëmbajtja dhe azhurnimi i regjistrit të anëtarëve të fondeve të detyrueshme pensionale***

Një prej punëve që i kryen MAPAS sipas vendimit të rregullativës është mirëmbajtja e regjistrit të anëtarëve dhe regjistrit të anëtarëve të pensionuar të fondeve të detyrueshme pensionale. Në këtë aspekt, gjatë viteve të kaluara të funksionimit të sistemit, janë konstatuar mungesa/parregullsi të caktuara të të dhënave nga anëtarët e shtyllës së dytë në aspekt të azhurnimit të tyre nga ana e vetë të siguruarve ose për shkak të mungesës së evidencave të të dhënave nga institucionet e involvuara prej ku merren një pjesë e të dhënave. Të siguruarit dhe në përgjithësi popullsia, kanë një sjellje inerte në raport me reagimin e tyre në kohë për të azhurnuar të dhënat e tyre personale, që me gjasë janë rezultat i nivelit ende të ulët relativ të “arsimimit dhe kulturës pensionale” të popullsisë së përgjithshme dhe gjithsesi të motivimit të dobët për azhurnim me vetiniciativë për të dhënat personale që ndryshohen. Gjithashtu një pjesë e institucioneve të inkuadruar në shpërndarjen e të dhënave, për shkak të disa arsyeve, jo rrallë kanë edhe evidenca të mangëta. Ky ndikim negativ i qasjes deri te anëtarësia e rëndon komunikimin me MAPAS dhe shoqëritë pensionale me anëtarët e shtyllës së dytë, që në fund i implikon edhe përmes nivelit të pakënaqshëm të informimit të anëtarëve.

Sistemi vazhdimisht “piqet” përmes rritjes së përfshirjes së popullsisë edhe përmes rritjes së vazhdueshme të mjeteve të fondeve të detyrueshme pensionale me çka rëndësia e sigurimit pensional me financim kapital edhe rritet. Me këtë potencohet rëndësia e mirëmbajtjes së të dhënave të azhurnuara dhe të kompletuara, si nga aspekti i rolit personal të individit, ashtu edhe për shkak të vetëdijes së përgjithshme të publikut dhe përkrahjes së sistemit.

Pastaj edhe përkundër faktit që në vitet në vijim pritet që një numër i vogël i anëtarëve të fondeve të detyrueshme personale të realizojnë kushte për pensionim, MAPAS në periudhën në vijim do të orientohet ndaj krijimit, udhëheqjes dhe azhurnimit të plotë të regjistrit të anëtarëve të pensionuar.

Në drejtim të mirëmbajtjes dhe përmirësimit të qasjes së anëtarësisë, MAPAS do të zbatojë dhe iniciojë aktivitete për përmirësimin e proceseve për azhurnimin e të dhënave dhe do të kërkojë përmirësimin e evidencave nga të gjitha institucionet që kanë të dhëna burimore për të siguruarit.



Gjithashtu në vitet e ardhshme, MAPAS do të vazhdojë me aktivitetet për kontrollimin e të dhënave për anëtarësinë në fondet pensionale vullnetare që merren nga shoqëritë pensionale. Këto aktivitete janë në drejtim të sigurimit të plotësimit të kërkesave dhe rregullave në lidhje me përfshirjen e anëtarëve në shtyllën e tretë, si dhe një kontroll të plotë, ndjekje vijuese dhe analizë të gjendjes me anëtarët në fondet pensionale vullnetare.

### ***Garantimi i besueshmërisë dhe konsistencës së bazës së të dhënave***

MAPAS ka një rol tejet të rëndësishëm në mirëmbajtjen e bazave me të dhëna ku bëjnë pjesë edhe të gjitha të dhënat për anëtarët e fondeve pensionale. Mirëmbajtja e bazave me të dhëna kontribuon në besueshmërinë e të dhënave dhe krijon siguri për secilin anëtarë se mund t'i ndjekë kontributet që paguhen në llogarinë e tij individuale. Këto të dhëna, njëherë do të duhet të mundësojnë që MAPAS t'i kontrollojë të dhënat që shfrytëzohen nga shoqëritë pensionale gjatë realizimit të funksioneve të tyre, siç është komunikimi me anëtarët, ndërsa të dhënat e shoqërive pensionale mund të shfrytëzohen për kontrollin e të dhënave që i ruan MAPAS.

Deri më tani nuk janë vërejtur probleme më të mëdha me evidencën e të dhënave për anëtarësinë, të shkaktuara nga incidentet e softuerit (në aspekt teknik ose për shkak të faktorit njeri), por duke marrë parasysh faktin se anëtarësia dhe mjetet edhe më tutje do të vazhdojnë të rriten, MAPAS do të ballafaqohet me një sfidë serioze për të garantuar se të dhënat e sistemit janë të besueshme dhe konsistente. Për këtë arsye, ky obligim edhe në të ardhmen do të jetë prioritet i lartë për MAPAS.

Në të ardhmen, MAPAS do ta avancojë IT perspektivën edhe në kontrollin në terren dhe jashtë terrenit, që realizohet me qëllim të fuqizimit të suksesit të mbikëqyrjes në të ardhmen.

### ***Sigurimi i kushteve për realizimin e papenguar të pagesës së pensioneve dhe kompensimeve pensionale për anëtarët e pensionuar dhe promovimi i proceseve me kualitet të lartë në lidhje me pagesën e pensioneve dhe kompensimeve pensionale***

Sigurimi i kushteve për realizimin e papenguar të pagesës së pensioneve dhe kompensimeve pensionale për anëtarët e pensionuar dhe promovimi i proceseve me kualitet të lartë në lidhje me pagesën e pensioneve dhe kompensimeve pensionale.

Në periudhën e kaluar nga miratimi i akteve ligjore dhe nënligjore, faza e pagesës së pensioneve dhe kompensimeve pensionale ishte implementuar pjesërisht, sepse anëtarët e fondeve pensionale ende ishin relativisht të rinj dhe realizoheshin pensione ose pagesa të shtyllës së dytë për vetëm një pjesë të vogël të anëtarëve. Më pas, me ndryshimet e Ligjit për sigurim pensional me financim të detyrueshëm kapital, nga dhjetori i vitit 2018 që ishin në lidhje me ndryshimin e kriterëve për anëtarësim në fondet e detyrueshme pensionale, në vitin 2019, u tregua se për një numër të madh të anëtarëve të moshuar për të cilët u dëshmuua se anëtarësia në shtyllën e dytë është e pamjaftueshme, e ndërprejnë anëtarësimin dhe këto të siguruar mbeten vetëm në sigurimin vijues të financuar pensional bazuar në solidaritetin e gjeneratave. Kjo gjendje mundësoi vazhdimin e kornizës së pritur kohore për fillimin e pagesës së pensioneve për një pjesë më të konsiderueshme të anëtarëve të fondeve të detyrueshme pensionale. Por edhe krahas asaj që pritet se në vitet e ardhshme, një numër i vogël i anëtarëve të fondeve të detyrueshme pensionale do të realizojnë kushte për pensionim, prapë se prapë MAPAS duhet që gjatë viteve të ardhshme të promovojë procese të kualitetit të lartë për pagesën e pensioneve dhe kompensimeve pensionale. Shërbimi në kohë dhe kualitativ i pagesës së pensionit nga shtylla e dytë për anëtarët që gjatë dhjetëve viteve të ardhshme do t'i realizojnë kushtet për pension, paraqet një faktor të rëndësishëm për ruajtjen e dinjitetit dhe besimit të qytetarëve të sigurimit pensional të financuar kapital.

Së bashku me shoqëritë pensionale, Fondi për SPIMV dhe ASO, MAPAS do të mundësojë implementimin e sigurt dhe të plotë të fazës së pagesës së pensioneve dhe me këtë do të sigurohet të krijohen të gjitha procedurat e nevojshme. Ajo nënkupton se për anëtarët do të duhet të krijohen sistemet dhe burimet e informatave përmes të cilave ata do të mund të bëjnë zgjedhjen e duhur që do të përkojë me nevojat

dhe gjendjet e tyre. Ajo nënkupton se faza e pagesës së pensioneve do të harmonizohet me zhvillimin e tregut të anuiteteve pensionale, avancimin e sigurimit të tërheqjeve të programuara dhe proceseve të krijuara për kontrollin e pagesës së mjeteve nga llogaritë e anëtarëve.

Paralelisht me aktivitetet për sigurimin e kushteve për realizimin e papenguar të pagesës së pensioneve, zhvillohen edhe aktivitetet në lidhje me pagesën e kompensimeve pensionale. Në aspekt të shtyllës së tretë, MAPAS gjatë viteve në vijim pret një numër më të madh nga fondet vullnetare pensionale (relative me gjendjen e tyre të përgjithshme) që t'i realizojnë kushtet për pagesën e kompensimeve pensionale, që gjithashtu paraqet një parakusht të konsiderueshëm për angazhim të shtuar për sigurimin e shërbimit kualitativ dhe në kohë, në lidhje me pagesat nga shtylla e tretë.

### Qëllimi strategjik 3:

#### ***Përmirësimi i kapacitetit në drejtim të forcimit të rolit mbikëqyrës dhe rregullues në sigurimin pensional të financuar kapital***

Kapaciteti i MAPAS është shumë i rëndësishëm për rregullimin e mirë dhe mbikëqyrjen efikas të sigurimit pensional me financim kapital. Për ta zhvilluar kapacitetin e vet, MAPAS në periudhën e përfshirë me Planin Strategjik do të orientohet ndaj disa sferave kryesore. Menaxhimi me resurset njerëzore do të jetë një prej çështjeve kyçe, zgjidhja e së cilës do të ndihmojë që MAPAS të avancohet si një organizatë më profesionale dhe më e mirë. Planet për trajnime do të dizajnohen dhe përgatiten për të përmirësuar kapacitetin e të punësuarve dhe të ekipit udhëheqës. Gjithashtu, MAPAS do të menaxhojë me të dhënat në mënyrë më profesionale në pajtim me nevojat e sistemit dhe do të ruaj zgjidhjet për mirëmbajtjen e vazhdimësisë zyrtare dhe rimëkëmbjes në rast të katastrofës (katastrofave natyrore, etj.). Më pas, MAPAS vazhdimisht do të avancojë proceset, procedurat dhe sistemet me qëllim të përmirësimit të efektivitetit të vet zyrtar. Gjithashtu, MAPAS në vitet në vijim do të punojë në ndërtimin e kulturës në të cilën menaxhimi dhe komunikimi për rreziqet e përcaktuara të punës, do të bëhet praktikë në bazë të së cilës do të miratohen vendime përkatëse. MAPAS vazhdimisht do ta ruaj bashkëpunimin me pjesëmarrësit e sistemit si në Maqedoninë e Veriut, ashtu edhe jashtë vendit, në drejtim të avancimit të mësimin të përbashkët dhe zhvillimit të sigurimit pensional të financuar kapital, ku MAPAS do a ruaj stabilitetin financiar duke siguruar menaxhim efikas me financat. MAPAS do ta avancojë menaxhimin, planifikimin, transparencën e saj si dhe përgjegjësinë shoqërore.

### ***Përsosja e vazhdueshme e profesionalizmit dhe kompetencave të organeve udhëheqëse dhe të punësuarve***

Profesionalizmi dhe kompetenca e organeve udhëheqëse dhe të punësuarve janë faktorë kyç që kontribuojnë në përmirësimin e kapacitetit të MAPAS për të siguruar funksionalitet dhe shërbime më të mira publike. Mënyra më e mirë për ndërtimin e profesionalizmit dhe kompetencës është përmes menaxhimit me resurset njerëzore. Përmes menaxhimit përkatës dhe të mirë definuar të resurseve njerëzore mund të krijohen strategjitë dhe të zhvillohen politikat, standardet, sistemet dhe proceset përmes të cilave do të realizohen ato strategji në pothuajse të gjitha sferat. Në pesë vitet e ardhshme, MAPAS do të vazhdojë me avancimin e menaxhimit me resurset njerëzore, me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe efektivitetit të potencialit njerëzor që do të kontribuojë për forcimin e kapacitetit të MAPAS.

MAPAS do të vazhdojë me planifikimin e rritjes së resurseve njerëzore në bazë të një analize me të cilën do të konstatohet gjendja ekzistuese dhe nevoja për përfshirjen e kuadrove të reja dhe për këtë do të miratohet Plan vjetor i trajnimit.

MAPAS gjatë viteve në vijim do të vazhdojë të mundësojë zhvillimin e shkathtësive profesionale, teknike dhe sociale për të punësuarit përmes trajnimeve të specializuara dhe gjenerike, për çka do të miratohet Plan vjetor i trajnimit të të punësuarve në MAPAS, sipas Programit për trajnimin e nëpunësve administrativ në Republikën e Maqedonisë së Veriut si dhe Planin për trajnime të specializuara për secilin nëpunës në veçanti. Kjo njëherë do të kontribuojë për një zhvillim të vazhdueshëm të kompetencave të të punësuarve, shfrytëzim më të mirë të resurseve njerëzore, si dhe për motivimin e të punësuarve.

MAPAS gjithashtu do të punojë në avancimin e procesit të vlerësimit të të punësuarve, që do të kontribuojë për ndjekjen aktive të kapaciteteve vijuese të MAPAS dhe ndërmarrjen e aktiviteteve përkatëse drejt avancimit të kapaciteteve të MAPAS.

MAPAS gjatë punës së vet do të vazhdojë të sigurojë nivelin më të lartë të sjelljes profesionale dhe etike përmes ndjekjes së standardeve të Kodit të etikës profesionale të të punësuarve dhe nga Kodi i etikës profesionale të të punësuarve gjatë realizimit të mbikëqyrjes në terren dhe jashtë terrenit, si dhe nga Kodi i nëpunësve administrativ. Organi udhëheqës i MAPAS do t'i ndjekë edhe standardet e Kodit për sjellje etike për anëtarët e Qeverisë dhe bartësit e funksioneve publike, të emëruar nga ana e Qeverisë.

### ***Sigurimi i vazhdueshëm i menaxhimit efikas me rreziqet gjatë punës***

Proceset zyrtare në MAPAS e promovojnë efektivitetin dhe efikasitetin zyrtar duke synuar inovacionet, fleksibilitetin dhe integrimin me teknologjinë. Këto procese zyrtare janë të konfirmuara me implementimin e Sistemit standard për menaxhime kualitet ISO 9001:2015 dhe mirëmbajtjen e tij të vazhdueshme (certifikimin). Avancimi i vazhdueshëm i punës dhe proceseve zyrtare në MAPAS, përmirësimi i organizimit të aktiviteteve të punës dhe ndjekjen e performancave, japin një ndikim më të madh pozitiv ndaj sistemit të përgjithshëm dhe kontribuojnë në arritjen e një mbikëqyrje dhe kontrolli modern, efikas dhe profesional. MAPAS në vitet në vijim do të vazhdojë me vlerësimin e të gjitha proceseve, hapave dhe sistemeve që janë në funksion dhe do të vazhdojë me përmirësimin e proceseve zyrtare.

Me qëllim që MAPAS të përgatitet për nevojat teknologjike në rritje, që paraqiten viteve në vijim, është e domosdoshme që të përpilohet një IT strategji. Ai dokument përfshinë planifikimin e arkitekturës, planifikimin e shpenzimeve dhe menaxhimit me sigurinë e të dhënave, e tërë kjo në harmonizim me qëllimet dhe kontrollet zyrtare.

Për një trajtim në kohë të të gjitha kërcënimeve dhe rreziqeve, MAPAS në vitin 2015 e implementoi dhe rregulloi Sistemin për menaxhim me sigurinë e informatave (ISO 27001:2013) që siguron një nivel adekuat të sigurisë në aspekt të besueshmërisë, disponimit dhe integritetit të mjeteve informatike të MAPAS. Plani për vazhdimësi të punës zyrtare, regjistrin të rreziqeve si dhe planit për trajtimin e rreziqeve që janë pjesë e Sistemit të menaxhimit me sigurinë e informatave, janë kyçe sepse mundësojnë ruajtjen e funksionalitetit të institucionit në situata të padëshiruara siç janë ndërprerja e energjisë, ngecje të IT sistemit, katastrofave natyrore, problemeve me furnizimet, etj. Përmirësimi i vazhdueshëm i këtij sistemi për menaxhimin me sigurinë e informatave në vitet në vijim, është në drejtim të ruajtjes së vlerës së palëve të interesuara përmes një vlerësimi të vazhdueshëm dhe përmirësimit të sigurisë informatike dhe tërë ciklit për zhvillim të vazhdueshëm të MAPAS.

Të udhëhequr nga ky qëllim, në drejtim të përmirësimit të punës së vet, MAPAS gjatë vitit 2018 krijoi një Sistem për menaxhimin me rreziqe, në bazë të së cilit u analizuan të gjitha proceset zyrtare, si nga Sistemi për menaxhim me kualitet, ashtu edhe nga Sistemi për menaxhim me sigurinë e informatave. Me ndihmën e Sistemit për

menaxhimin me rreziqe, u siguraa përcaktimi i vlerësimit dhe kontrollit të ngjarjeve ose gjendjeve të mundshme që mund të kenë ndikim negativ në arritjen e qëllimeve. MAPAS me sukses i identifikoi rreziqet e punës në nivel të njësive organizative, sipas një metodologjie, e cila përfshinë përcaktimin e rreziqeve, vlerësimin e rreziqeve, veprimin me rreziqet dhe ndjekjen dhe raportimin mbi ato rreziqe. Qëllimi i menaxhimit me rreziqe është ulja dhe/ose ruajtja e rreziqeve deri në një nivel të definuar si të pranueshëm, përmes ndërmarrjes së aktiviteteve adekuate për të cilat është e domosdoshme ndjekja dhe vlerësimi i vazhdueshëm i rreziqeve.

Me qëllim që menaxhimi me rreziqet të jetë pjesë përbërëse e procesit të planifikimit dhe miratimit të vendimeve, MAPAS është në një proces të ndërtimit të kulturës në të cilën menaxhimi dhe komunikimi për rreziqet e përcaktuara do të bëhet praktikë në bazë të së cilës do të miratohen vendime përkatëse. Gjatë viteve në vijim, MAPAS do të vazhdojë të implementojë dhe avancojë Sistemin për menaxhimin me rreziqe.



### Oëllimi 3.3

---

#### ***Bashkëpunimi edhe me trupa të tjerë mbikëqyrës nga vendi dhe jashtë, do të jetë pjesë e shoqatave ndërkombëtare dhe implementimi i proceseve dhe rekomandimeve më të reja nga sfera e mbikëqyrjes, si dhe pjesëmarrja në projekte të organizuara nga institucionet kompetente***

Me qëllim të sigurimit të mbikëqyrjes efikase dhe rregullativës së sigurimit pensional me financim kapital, MAPAS do të vazhdojë të bashkëpunojë edhe me trupat rregullatorë nga vendi dhe jashtë, si dhe me organe dhe institucione relevante të vendit. Me këto trupa dhe institucione, MAPAS ka definuar bashkëpunimin me memorandume bashkëpunimi. Përmes këtyre bashkëpunimeve, MAPAS përfiton nga përvojat dhe informatat e mbledhura dhe hulumtimet e ndara nga ana e institucioneve të tjera rregullatore.

MAPAS bashkëpunon me institucione rregullatorë në disa vende siç janë Bullgaria, Sllovenia, Kroacia, Polonia, Turqia, Rumania, Kosova dhe Shqipëria. Bashkëpunimi përfshinë shkëmbimin e përvojave të fituara në fushën e sigurimit pensional të financuar kapital, të punës së fondeve pensionale, mekanizmave për mbikëqyrjen e fondeve pensionale dhe rregullativës së miratuar dhe masave juridike. Bashkëpunimi i këtillë kontribuoi në zhvillimin e kapacitetit të MAPAS. Gjithashtu, nga marsi i vitit 2007, MAPAS është anëtare e plotfuqishme e IOPS – Organizatës ndërkombëtare të supervizorëve pensional. MAPAS, si bazë dhe politikë në kuadër të realizimit të mbikëqyrjes së shoqërive pensionale dhe fondeve pensionale, u përcaktua për ndjekjen e Parimeve për mbikëqyrje të Organizatës ndërkombëtare të supervizorëve pensional. Anëtarësimi dhe bashkëpunimi me IOPS kontribuon që MAPAS t'i ndjekë trendët në sferën e rregullativës dhe supervizionit të shoqërive dhe fondeve pensionale. MAPAS do të vazhdojë avancimin e këtyre bashkëpunimeve dhe do të vazhdojë të shpërndajë dhe shkëmbejë informata dhe përvoja, për t'i ndjekur standardet botërore të praktikave pozitive nga sfera e mbikëqyrjes së shoqërive pensionale dhe fondeve pensionale

Nga dhjetori 2013 MAPAS është pjesë e Trupit koordinues të institucioneve rregullatorë të Maqedonisë për edukim financiar, që u formua me qëllim të nxitjes, planifikimit dhe realizimit të aktiviteteve që kanë për qëllim ngritjen e nivelit të arsimimit financiar të popullsisë në Republikën e Maqedonisë. Trupi koordinues bashkëpunon me disa institucione të sektorit financiar nga vendi dhe jashtë, veçanërisht duke theksuar bashkëpunimin me Organizatën për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik – Rrjeti ndërkombëtar për edukim financiar (OECD-INFE) dhe Organizata Ndërkombëtare për Edukim Financiar të Rinjve dhe Fëmijëve (CJFI) si organizata dhe institucione ndërkombëtare me renome

që në mandatet e tyre i përpunojnë rregullativat, temat dhe programet për edukim financiar, arsimim financiar dhe inkluzion financiar.

Në prill të vitit 2020, institucionet rregullatorë në Maqedoninë e Veriut kanë nënshkruar Memorandum për bashkëpunim ndërinstytucional për ruajtjen e stabilitetit financiar në pajtim me rekomandimet e FMN dhe BB.

MAPAS gjatë viteve në vijim do të marrë pjesë aktive në projekte që kanë lidhje me përmirësimin e funksionimit të sigurimit pensional të financuar kapital. Një pjesë e atyre projekteve do të dalin nga rekomandimet për lehtësimin e sektorit financiar nga ana e misionit të BB dhe FMN (FSAP) nga viti 2018. Gjithashtu, MAPAS do të marrë pjesë në aktivitetet në lidhje me projektin e Bankës Botërore për regjistër të unifikuar qendror dhe sistem për regjistrimin e të dhënave nga sigurimi social dhe pensional.

Në vitet e ardhshme MAPAS do të vazhdojë me avancimin e praktikës së krijuar të bashkëpunimit, për ruajtjen e komunikimit të suksesshme me trupat e tjerë mbikëqyrës dhe organet dhe institucionet relevante, me qëllim që ajo të kontribuojë në ruajtjen e një sigurimi pensional stabil dhe transparent me financim kapital dhe avancimin e mbikëqyrjes së sigurimit pensional të financuar kapital.

### ***Forcimi dhe ruajtja e stabilitetit financiar me qëllim të zbutjes së ndikimeve në të gjitha segmentet e fushëveprimit duke siguruar një menaxhim efikas të financave***

MAPAS vazhdimisht i ndjek gjendjet dhe trendët që kanë lidhje me punën e MAPAS dhe sistemi e avancon dhe nxit zhvillimin e sigurimit pensional me financim kapital. Në këtë drejtim, planifikohet realizimi i aktiviteteve për rregullimin dhe implementimin e multifondeve dhe pritet krijimi i Qendrës për sistem elektronik të kotacionit. Këto ndryshime do të implikojnë rritjen e kapaciteteve të MAPAS nga kapaciteti rregullator në atë mbikëqyrës, e me këtë edhe shpenzimet për forcimin e kapacitetit kadrovik dhe material të Agjencisë. Gjithashtu, MAPAS vazhdimisht i avancon dhe përsos proceset zyrtare sipas nevojave dhe kërkesave të paraqitura për të gjitha subjektet e kyçura në sistemin e sigurimit pensional me financim kapital. Proceset zyrtare janë të përkrahura me zgjidhje bashkëkohore softuerike dhe harduerike që kontribuojnë në shpejtësinë e reagimit të MAPAS dhe ndjekjes pa pengesa të secilit ndryshim që shkaktohet në këtë sistem. Për këtë arsye, një pjesë të shpenzimeve të MAPAS janë për infrastrukturën e saj informatike.

Sigurimi pensional me financim kapital paraqet segmentin e dytë më të madh në sistemin financiar të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe është një prej segmenteve me rritje më të shpejtë të sistemit financiar. Në vitin 2019 mjetet e fondeve private pensionale ishin 11,5% nga sektori i përgjithshëm financiar. Me këtë rast pritet një trend i përfshirjes së popullsisë dhe të vazhdojë edhe më tutje rritja e mjeteve për fondet private pensionale . Kjo ndikon drejtpërdrejtë edhe në rritjen e përgjegjësisë së MAPAS si një trup mbikëqyrës dhe rregullues në këtë segment, para të siguruarve dhe publikut.

Me analizat e mënyrës së tanishme të përlllogaritjes dhe arkëtimit të kompensimit me të cilin financohet puna e MAPAS, është konstatuar se shkalla e punësimeve dhe masave populiste kanë ndikim negativ në kompensimin e strukturuar momental, respektivisht nivelit të frekuencës së kontributeve që ndikojnë drejtpërdrejtë në financimin e MAPAS. Për tejkalimin e këtyre ndikimeve, stabilizimit të të hyrave si dhe harmonizimin me praktikën e huaj, me qëllim të realizimit të aktiviteteve që dalin nga zhvillimi i mëtejshëm i sistemit, në bazë të analizave të përpiluara dhe duke siguruar kufizime maksimale për të përcaktuar nevojën për ndryshimin e mënyrës së përlllogaritjes së kompensimit që e arkëton MAPAS nga shoqëritë pensionale. Për këtë, MAPAS do të iniciojë ndryshim ligjor për

mënyrën e përlogaritjes së kompensimit, respektivisht arkëtimit të kompensimit mujor në llogarit të shoqërive pensionale, të përlogaritur si përqindje e mjeteve të përgjithshme për çdo fond pensional me të cilin shoqëria pensionale.

MAPAS udhëheq me kontabilitetin në pajtim me Ligjin për kontabilitet për organizatat joprofitabile, Rregulloren e kontabilitetit për organizatat joprofitabile dhe parimet dhe standardet e pranueshme të kontabilitetit, me qëllim të prezantimit të saktë, të vërtetë, të siguritë, gjithëpërfshirës, në kohë, të azhurnuar dhe individual të rreziqeve të bilancit, me gjendjen e mjeteve, obligimeve, burimeve të mjeteve, të hyrave dhe shpenzimeve, si dhe rezultateve të punës. MAPAS do të vazhdojë me përgatitjen, prezantimin dhe publikimin e raporteve financiare. Kjo përgjegjësi përfshinë: krijimin, implementimin dhe mirëmbajtjen e kontrollit të brendshëm që është relevante për përgatitjen dhe prezantimin objektiv të raporteve financiare që janë të lira nga prezantimi i gabueshëm material, pa dallim nëse është rezultat i ndonjë mashtrimi ose gabimi, përzgjedhje ose zbatimimi të politikave të kontabilitetit , si dhe vlerësime të arsyeshme sipas rrethanave të dhëna.

MAPAS gjatë viteve në vijim do të sigurojë një menaxhim të vazhdueshëm të financave, përfshirë edhe kontrollin e shpenzimeve operative dhe shfrytëzimit minimal të të hyrave. Në këtë drejtim, MAPAS do të bëjë analiza të raporteve financiare, do t'i rishqyrtojë vendimet për kompensimet dhe do ta përcaktojë nevojën për përpilimin e analizave plotësuese në lidhje me financimin e MAPA

### ***Avancimi i menaxhimit, planifikimit, transparencës dhe përgjegjësisë profesionale***

MAPAS do të vazhdojë me avancimin e menaxhimit të vetëm përmes mjeteve të menaxhimit me ndryshime, respektivisht përmes analizës së gjendjes momentale dhe përcaktimit të sferave që duhet të përmirësohen. MAPAS në vitin 2019 ka realizuar një analizë funksionale. Analiza bëhet për të përkufizuar pozitën dhe ndarjen e kompetencave të organizatës; rishqyrtimit se cilat njësi organizative dhe procese të punës nuk janë efikas dhe efektive, andaj sipas kësaj duhet që edhe të transferohen, plotësohen, ndryshohen, etj., si dhe të efikasitetit dhe efektivitetit të realizimit të funksioneve dhe nevojës për shqyrtimin e proceseve të punës. Analiza e MAPAS, nga aspekt organizativ, e ka detektuar nevojën për inkuadrimitin e proceseve dhe aktiviteteve të reja dhe përsosjen e atyre ekzistuese në korrelacion me kapitalin ekzistues njerëzor dhe punësimet e reja. MAPAS në vitet në vijim pret se implementimi i rekomandimeve të potencuar konkrete të analizës, në pajtim me kornizën e planifikuar për përmirësimin e kapaciteteve në MAPAS, do të sjellë deri te avancimi i organizimit të brendshëm dhe proceseve të punës.

MAPAS do ta zhvillojë menaxhimin e vet edhe përmes avancimit të komunikimit dhe koordinimit ndërmjet të gjitha njësive organizative, si dhe përmes ngritjes së vetëdijes të punësuarit në aspekt të rreziqeve të punës.

MAPAS do të vazhdojë që edhe në vitet në vijim ta zbatojë dhe avancojë procesin e planifikimit strategjik si një mjet për përshtatjen e shpejtë dhe efikase ndaj kushteve të ndryshueshme të veprimit. MAPAS do të analizojë edhe gjendjen ekzistuese në të cilën punon dhe vepron, dhe në bazë të kësaj, në pajtim me kapacitetet dhe resurset e veta, në mënyrë reale dhe objektive do t'i përcaktojë qëllimet dhe gjendjet e synuara, aktivitete dhe do t'i ndjek dhe vlerësojë edhe realizimet. Planifikimi dhe arritja e gjendjeve të synuara do të bëhet në kornizën kohore në afat të shkurtë dhe të mesëm, duke siguruar menaxhim efikas me financat, përfshirë edhe kontrollin e shpenzimeve operative dhe shfrytëzimin optimal të të hyrave.

MAPAS do të zbatohet mesatarisht në 30 deri 40 procedura të furnizimeve publike për mallra, shërbime dhe punë, varësisht nga nevojat në nivel vjetor. Në këtë drejtim, MAPAS në mënyrë aktive do t'i ndjekë ndryshimet dhe plotësimet dhe do të përshtatë punën e vet sipas të njëjtave, duke u adaptuar ndaj inkuadrimit të mënyrave moderne (elektronike) të udhëheqjes së procedurave dhe evidentimit të tyre, që kontribuon ndaj një praktike dhe pragmatike më të madhe të realizimit të tyre në njërin anë,

si dhe transparencës dhe llogaridhënies në tjetrën anë. MAPAS do të vazhdojë me këtë mënyrë të punës edhe në të ardhmen, duke synuar rritjen e kapaciteteve të veta me qëllim që me sukses dhe efektivitet të përgjigjet ndaj të gjitha sfidave që i bart në vete problematika e furnizimeve publike.

Në vitet në vijim MAPAS edhe më tutje do të vazhdojë me avancimin e akteve që kanë të bëjnë me punën e MAPAS dhe në mënyrë adekuate do t'i harmonizojë me ndryshimet e rregullativës përkatëse (marrëdhënieve të punës, sigurisë dhe shëndetit në punë, nëpunësve administrativ, mbrojtjen e të dhënave personale, qasjes deri te informatat me karakter publik, punës së zyrës dhe arkivit, etj.). Pastaj, MAPAS do të vazhdojë të punojë në ruajtjen e kushteve të sigurta dhe kualitative të punës, në pajtim me kërkesat, standardet dhe normat zyrtare, të përcaktuara në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

MAPAS gjatë viteve në vijim do t'i kushtohet edhe aktivitetëve për avancimin e përgjegjësisë së vet shoqërore, përmes inicimit dhe inkuadrimin në aktivitete të përmirësimit të aspekteve sociale dhe etike të shoqërisë tonë dhe përmirësimit të ambientit jetësor.

MAPAS gjatë viteve të kaluara, ka krijuar një revizion të brendshëm si aktivitet i pavarur i vlerësimit dhe këshillimit objektiv, me qëllim që ajo të kontribuojë në rritjen e vlerës dhe përmirësimit të punës në MAPAS. Në vitet në vijim, revizioni i brendshëm do të vazhdojë që në mënyrë sistematike t'i vlerësojë dhe të japë rekomandime për përmirësimin e procesit të menaxhimit me rreziqet, përshtatjen dhe efektivitetin e kontrolleve të brendshme dhe përshtatjes së punës me rregullat në fuqi, aktet dhe procedurat e brendshme të MAPAS. Revizioni i brendshëm do të vazhdojë me planifikimin, organizimin dhe realizimin e revizioneve në pajtim me aktet ligjore dhe nënligjore si dhe standardet ndërkombëtare të revizionit të brendshëm.

MAPAS siguron publikimin në kohë dhe të rregullt të informatave për punën e MAPAS, përmes raporteve të punës dhe punës financiare në MAPAS, publikimi i kumtesave në lidhje me punën e Këshillit të ekspertëve, furnizimet publike, projektet, etj. Gjatë viteve në vijim, MAPAS do të vazhdojë të punojë në përmirësimin e transparencës përmes avancimit të kualitetit dhe përfshirjes së të dhënave dhe informatave të punës së vet, për të gjitha palët e interesuara dhe shfrytëzuesit e jashtëm.